

Dalës-izlazna

Nr. -1-167
Br.

Data 15.11.2023
Datum

OBILIQ-OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.10.2023, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, nx.e SHMT "İsmail Dumoshi" përf. e OJQ-ë, "Toka" dhe nx.e gjimnazit "17 Shkurti"

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo"
4. Shqyrtimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina për realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo"
5. Shqyrtimi i Raportit financiar të shpenzimeve janar-shtator 2023
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesja – Fillimisht kërkoi nga anëtarët e KPF-së, nëse pajtohen që në këtë mbledhje të jenë prezentë përf. e OJQ-së "Toka" nxënësit e gjimnazit "17 Shkurti" dhe nxënësit e SHMT "İsmail Dumoshi". Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa u pajtuan që në mbledhje të prezentojnë përfaqësuesit dhe nxënësit e cekur më lartë.

Pastaj, kryesuesja i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina për realizimin e projektit të ngrohjes diellore “Solar4Kosovo”.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi që kjo marrëveshje ti rekomandohet Kuvendit dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo marrëveshje ti rekomandohet Kuvendit, pastaj atje kemi diskutime lidhur me këtë marrëveshje. Secila marrëveshje që i sjellë diçka të mirë Obiliqit, është e mirëseardhur për neve dhe për të gjithë qytetarët, prandaj atje do të provojmë me dhënë kontributin tonë me një vërejtje, apo këshillë që kemi në këtë drejtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës, me nr.-II-1458. të dt.16.10.2023, marrëveshja nr.-II-1337, e dt.26.09.2023. e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina për realizimin e projektit të ngrohjes diellore “Solar4Kosovo”.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina për realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore “Solar4Kosovo”.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi dakord që të ia rekomandojmë Kuvendit dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Kjo është vazhdimësi e pikës paraprake dhe kjo ka mund me qenë në një pikë krejtë, por sido që të jetë është e njehta dhe jemi pro.

Kryesuesja – Sqaron se ligji e kërkon që të shkojnë ndaras si pika dhe të votohen ndaras.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës, me nr.-II-1458. të dt.16.10.2023, marrëveshja nr.-II-1338, e dt.26.09.2023, e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina për realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore “Solar4Kosovo”.

Kryesuesja – Ju keni pranuar një memorandum mirëkuptimi në mes të Komunës së Obiliqit dhe KEK-ut dhe kjo mbetet vetëm si njoftim që ti rekomandojmë Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Njoftimin me Memorandumin e Mirëkuptimit nr.-II-729, i dt.01.06.2023, lidhur në mes të Komunës së Obiliqit dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve janar-shtator 2023.

Enver Gashi – E përgëzoj drejtoreshën e DEFZH-së, që menjëherë pas kalimit të muajit shtator e sjellë raportin dhe kjo është një dukuri e mirë, që është për lëvdatë. Ne si grup nuk kemi vërejtje në këtë raport ndërsa, kush ka vërejtje mund ti japë në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti - Unë për dallim e falenderoj për punën që duhet me bë dhe e ka obligim dhe mirë që është ky raport, e mirëpresim si të tillë deri në ditën e seancës dhe jemi që kjo të shkoj n ë seancë, ndërsa atje nëse kemi vërejtje gjithsesi se do ti japim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve janar-shtator 2023.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve nr.-II-1334, i dt.25.09.2023, të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit 2022.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve nr.-II-1334, i dt.25.09.2023, t ë dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit 2022.

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Propozimit të Kryetarit të Komunës me nr.-II-1466, i dt.20.10.2023, për miratimin e Raportit përfundimtar nr.-XVI-136, të dt.19.10.2023, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shiu (vërshimet) dhe breshëri në muajin prill, qershor dhe korrik të vitit 2023.

Enver Gashi – Neve, na ka ardhë si Propozim i Kryetarit dhe shumën e mjeteve e kemi, por kujt iu kanë ndarë mjetet dhe si ju kanë ndarë nga Komisioni nuk kemi material. Unë kërkoj nga ju dhe nga Drejtorja e bujqësisë që në mbledhjen e Kuvendit, të na sjellë edhe materialin plotësues.

Sami Ahmeti - Është kërkesë e re, do të thotë mirë është me bisedue për këtë çështje, por gjithsesi a kemi kohë ne me shqyrtue atë material për këtë kohë dhe mundësisht nëse, diçka e tillë veç hyn si pikë e rendit të ditës sepse nuk jemi për me bllokue, le të na vjen materiali sa më heret. Sa i përket internetit dje ka bë me i dërgue dokumentet tjera, por nesër është dashtë me dërgue diçka tjetër, nuk është që pin shumë ujë. Gjithsesi është mirë që materialin me dërgue me kohë, kemi transparencë të plotë dhe ne edhe pse jemi opozitë jemi që çdo gjë që është e mirë ndoshta, e keni vërejtë qasjen jo vetëm me ngritë dorën, por edhe me i aplauzue asaj pune sepse e kemi obligim dhe ne jemi duke i shërbyer qytetarëve të njejtë. Ne jemi dakord që kjo të shkoj në rend dite si pikë megjithatë, materialet është mirë të na vijnë me kohë në mënyrë që edhe ne jo të mundemi gjithmonë me kritikue, por të japim kontributin tonë nëse, dikujt iu kanë shkelë të drejtat.

Kryesuesja – Sqaron se kërkesa e Idriz Aliut, dje ka ardhë me dt.03.10 dhe po ashtu ishte shqyrtimi i raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve, dihet numri i protokolit që kanë ardhë shumë më heret, por vërtetë nuk kemi pasë qasje në internet atë ditë komplet kati i parë

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin shqyrtimin dhe aprovimin e Propozimit të Kryetarit të Komunës me nr.-II-1466, i dt.20.10.2023, për miratimin e Raportit përfundimtar nr.-XVI-136, të dt.19.10.2023, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shiu (vërshimet) dhe breshëri në muajin prill, qershor dhe korrik të vitit 2023.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nr.-VI-020-699/5, të dt.05.10.2023, nga MAPL-ja, për rishqyrtim të vendimit nr.-I-117, i dt.30.08.2023, “Bermas Therm” SH.P.K.

Enver Gashi – Është një vendim që e ka marrë Komuna, ndoshta pa u konsultuar mirë me Rregulloren se si janë dhënë ato prona dhe bizneseve qysh iu ka dhënë leja e operimit. Mendoj se Kryetari, ose zyra e Kryetarit duhet të negocijoj dhe prapë ai vendim do të vijë në Kuvend për votim, por këtë vendim që ne e kemi marrë nuk ka shkue mirë proceduralisht dhe jemi për ne shfuqizue.

Sami Ahmeti – Duke pasë parasysh se është mandati i parë i këtij Ekzekutivi, e pranojmë se ka bë gabime pa qëllim kështu që jemi pro që të shkoj si pikë e rendit të ditës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës nr.-VI-020-699/5, të dt.05.10.2023, nga MAPL-ja, për rishqyrtim të vendimit nr.-I-117, i dt.30.08.2023, “Bermas Therm” SH.P.K.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për rishqyrtimin e vendimit nr.-I131, të dt.28.09.2023, për aprovimin e Planit lokal të veprimt për cilësi të ajrit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që edhe kjo kërkesë të rishqyrtohet në Kuvend.

Sami Ahmeti – Natyrisht vendimet që merren dhe kanë vërejtje nga Ministritë duhet të kthehen në Kuvend për ti bërë ndryshimet e duhura. Është shqetësuese pak çështje se krejtë këto ndërliiden me ligje, me nene të cilat Zyra ligjore ka qenë dashtë të jetë e përditësuar megjithatë, ne e dërgojmë në pikë të rendit të ditës dhe atje i bëjmë ndryshimet e duhura. Gabimet mund të ndodhin, por po janë shumë të shpeshta.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal kërkesën nr.5833-2/23, e dt.23.10.2023, nga MMPHI-ja, për rishqyrtimin e vendimit nr.-I-131, të dt.28.09.2023, Aprovohet Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit në Komunën e Obiliqit.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Idriz Aliu, i cili kërkon subvencionim për blerje të autobusëve.

Enver Gashi – Ne jemi dakorduar që të gjitha kërkesat së pari të shkojnë në Drejtoritë përkatëse, kështu që kjo kërkesë duhet të shkojë në DSHPE, pastaj drejtori vjen me një rekomandim në Kuvend.

Sami Ahmeti – Këtu, është çështja se vazhdimisht na vijnë kërkesat e tilla dhe unë e kuptoj derisa na drejtohen neve si Kuvend jemi dakord që ato ti bisedojmë. Kërkesa si e tillë i mungojnë disa elemente sepse ai thotë autobus në shumës 120,000 euro, jo të ri, do të thotë nuk ka çmime të autobusëve, nuk ka sasi dhe nuk ka kurrfarë paramase. Megjithatë, e kuptoj se gjendja e këtyre autobusëve që e bëjnë transportimin e udhëtarëve, nuk është e mirë. Drejtoritë duhet të vijnë me shpjegime se ne a kemi mundësi me buxhetin tonë me mbulue diçka të tillë, që paralelisht kërkesave nëse, kërkesa na vjen në Kuvend të vjen edhe arsytimi prej Ekzekutivit se a kemi buxhet sepse kërkesat mund të jenë, por kur nuk janë mundësitë nuk kemi çka bëjmë. Unë jam dakord me parafolësin se ne veç jemi marrë vesh që kërkesat e tilla të kalojnë filtrin e Ekzekutivit, pastaj të vijnë këndeje edhe pse e kuptojmë që qytetarët po na drejtohen neve.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal kërkesën nr.-I-29132/2023, e dt.03.10.2023 nga Idriz Aliu për subvencion për blerje të autobusëve për transportin e udhëtarëve të Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Sami Ahmeti - Unë i kam 2 kërkesa, ose pyetje të përsëritura. E para është çështja e tenderit të dritave, ku kanë mbetë shumë lagje dhe rrugë, kanë ende problem me ndriçim, ose me prishje të disa pjesëve të ndriçimit. E dyta të çështja e shkollave, në seancën e kaluar e biseduam mungesën e ujit në njërin nga shkollat, në këtëast specifikisht Millosheva, çka ka bërë Ekzekutivi, a ka pasë takime me KRU-në dhe a i ka rregullue këto problem. Po ashtu, paralelisht kësaj kushdo që jepë raport nga Drejtoria e Arsimit, të na ofroj informata nëse ka materiale të bollshme shkollore qoftë letër, qoftë printer, qoftë tonera që mos me pasë probleme me mësimdhënësit. Paralelisht kësaj gjendjen e stafit, a ka mungesa dhe sa kemi staf të cilët janë në procedura.

Mbledhja përfundoi në ora 11:35'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

